



Vërtetimet

Informatat në vijim iu referohen vërtetimeve të kopjeve dhe të nënshkrimeve. Informata mbi legalizimin dhe vërtetimin e çertifikatave zyrtare të Republikës së Kosovës gjëni në fletinformacionet „Legalizimi“, gjëgjësisht „Vërtetimi i çertifikatave“.

Vërtetimi i kopjeve

Nëse ju duhet të paraqitni dokumente, si dëftesa, dokumente të identifikimit, apo çertifikata të gjëndjes civile për t' i përdorur ato në Gjermani, ndërsa dëshironi t' i mbani origjinalet, ambasada mund t' i vërtetojë kopjet e këtyre dokumenteve.

Për të vërtetuar që një kopje, apo një duplikatë përputhet me origjinalin e një çertifikate, duhet të paraqitet edhe origjinali ose një kopje e vërtetuar e dokumentit origjinal. Nuk mund të vërtetohet një kopje e thjeshtë. Ju lutemi të paraqitni aq kopje sa ju duhen që të vërtetohen. Vërtetimi nuk i referohet përmbajtjes së çertifikatës.

Tarifa për vërtetimin e një kopje, sipas Rregullores për Shpenzime jashtë vendit për një dokument deri në 10 faqe në alfabet latin është 10,- euro dhe 1,- euro për secilën faqe pasuese.

Vërtetimi i nënshkrimeve

Nëpunësit konsullorë mund të vërtetojnë një nënshkrim, apo shenjë dore, nëse ato bëhen, ose njihen para nëpunësit konsullor. Për këtë arsye është e domosdoshme paraqitja personale e personit, nënshkrimi apo shenjat e gishtërinjve të të cilit mëtohet të vërtetohen.

Në rastin e vërtetimit të nënshkrimit kontrollohet dhe vërtetohet vetëm identiteti i nënshkruesit. Me këtë rast personi nuk informohet lidhur me rëndësishtë dhe pasojat e deklaratës. Megjithatë nëpunësi konsullor obligohet – rëndom përmes një bisedeje të shkurtër – që të sigurohet që nënshkruesi është i vetëdijshëm, çfarë nënshkruan. Ambasada në këto raste as bën përktimin me shkrim as aty për aty përktimin verbal të deklaratës së paraqitur në një gjuhë të huaj.

Për llogaritjen e tarifës sipas Rregullores së Tarifave jashtë vendit vlera e transaksionit ligjor definohet në përputhje me veprimin zyrtar përkatës (në rast të transaksioneve të patundshmërisë, p.sh. çmimi i blerjes, në rast të shoqërive kapitale, kapitali themelor). Vlera e tarifës është 20,- euro deri më së shumti 250,- euro.

Për vërtetim të nënshkrimit, luteni të paraqitni dokumentet në vijim:

1. Deklaratën që duhet nënshkruar;
2. Dëshminë lidhur me vlerën e transaksionit përkatës. Për deklaratë të miratimit nevojitet një kopje e kontratës, për vërtetime të regjistrimit tregtar, kopjet e vendimeve përkatëse të shoqërisë, apo çertifikatat e themelimit të noterizuar;
3. Pasaportën ose letërnjoftimin tuaj valid.

Shembuj për vërtetime të nënshkrimeve:

- Deklaratë e miratimit: Deklaratë me anë të së cilës një person, i cili është përfaqësuar gjatë lidhjes së një kontrate në Gjermani dhe i cili e miraton kontratën në mënyrë retrospektive
- Autorizimet me anë të të cilave dhënësi i autorizimit nuk obligohet në mënyrë të përvokueshme
- Kërkesat për vërtetime nga regjistri tregtar
- Parashtrimi i kërkesës për çertifikatë policore
- Deklaratë për pranimin e trashëgimisë.

Informatat e tjera, përtej këtyre të paraqitura mund të gjeni në uebfaqen e Ministrisë Federale për Punë të Jashtme: <http://www.konsularinfo.diplo.de/urkundenverkehr>.

Ju lutem vini re që vërtetimet bëhen vetëm me termin të caktuar paraprakisht nëpërmejt portalit të termineve të ambasadës. Portalin e termineve e gjeni në vegzën në vijim:
https://service2.diplo.de/rktermin/extern/choose_realmList.do?request_locale=de&locationCode=pris.

Këto të dhëna jepen në bazë të informatave, të cilat i ka pasur në dispozicion Ambasada Gjermane në Prishtinë në kohën e publikimit. Nuk merret përgjegjësi për plotësinë, saktësinë dhe aktualitetin e informatave.